



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS  
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT  
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë më, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik: “A l b G a r d e n” shpk

**Adresa:** LEZHE Lagjja "Skenderbeg", godine private 1 kateshe ne superstraden Lezhe - Shkoder, km 1

\* \* \*

Tipi i Kontratës: **Kontratë për Mallra**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **NR.REF-28858-11-11-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Pleh organik, humus, torfe, pleh kimik, pesticide**

**Kohëzgjatja e kontratës:** Afati i lëvrimit të mallit do të jete 50 (pesëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: *Data 12.12.2024*

<sup>1</sup>Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit *Buletini Nr.87 date 16 Dhjetor 2024*

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “A l b G a r d e n” shpk**

*NIPT-t: K37513520N*

Vlera e ofertës: 5.204.130 (pesëmilion e dyqind e katërmijë e njëqind e tridhjetë) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat: *Nuk ka nënkontraktor*

**2. Operatori ekonomik “AGRO – KORANI” shpk**

*NIPT-t: L13329801V*

<sup>1</sup>*Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP*

Vlera e ofertës: 5.734.500 (pesëmilion e shtatëqind e tridhjetë e katërmijë e pesëqind ) leke pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

*Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor*

**3. Operatori ekonomik “Gjelbërimi 2000” shpk** *NIPT-t: L21513012D*

Vlera e ofertës: 6.177.000 (gjashtëmilion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

*Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor*

**4. Operatori ekonomik “Besnik Çera” PF** *NIPT-t: K31427035Q*

Vlera e ofertës: 6.202.000 (gjashtëmilion e dyqind e dymije ) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

*Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor*

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. Operatori ekonomik “Besnik Çera” PF** *NIPT-t: K31427035Q*

Vlera e ofertës: 6 202 000 (gjashtëmilion e dyqind e dymije) lekë pa Tvsh

*për arsyet e mëposhtme*

a) *Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1 (a) përcaktohet sa më poshtë:*

**2.3. . Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Besnik Çera”, është konstatuar se operatori ekonomik është mbështetur në kapacitetet e operatorit ekonomik “2 N” shpk i cili ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në të cilin deklaroi se e mbështet operatorin ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “Besnik Çera” me mjetet dhe me Inxhinier Agromjedisi Z.Pajtim Hakorja. Në deklaratën e angazhimit dhe në marreveshje është deklaruar vetëm mbështetja me mjetet pa cilesuar stafin që do të vendoset në dispozicion të operatorit ekonomik.

Nga verifikimi i Formularit përmbledhës të vetdeklarimit të operatorit ekonomik “Besnik Çera” deklarohet se ai mbështetet në kapacitetet e operatorit ekonomik “2N” shpk për makinerite dhe 1 inxhinier agromjedisi.Z.Albert Marku.

Sa më sipër komisioni i vleresimit të ofertave konstaton mosperputhje të deklarimeve të bera nga subjekti pjesëmarrës në procedurë dhe nga subjekti mbështetes në lidhje me kapacitetet në të cilat do të mbështetet operatori ekonomik specifikisht në lidhje me Inxhinierin e agromjedisit i deklaruar Z.Albert Marku në shtojcën 9 të operatorit ekonomik Besnik Çera dhe i deklaruar Z.Pajtim Hakorja në shtojcën 9 të paraqitur nga subjekti mbështetes 2N shpk.

***b)Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, kapaciteti teknik pika 2.3.1 përcaktohet sa më poshtë:***

**2.3.1** Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate dhe konkretisht: 1.387.583 (një milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i së njëjtës natyre është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në funksion të plotësimit të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion provues sa më poshtë:

Fatura Nr.21, datë 26.04.2024 zërat e preventivit janë për pleh organik dhe kimik, vlera e faturës pa tvsh 650.000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Faturë Nr.39, datë 22.11.2023 zërat e preventivit janë për pleh organik dhe kimik, vlera e faturës pa tvsh 127.272 (njëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

Faturë Nr.38, datë 26.10.2023 vetëm njëri nga zërat e preventivit është për pleh organik dhe kimik, i ngjashëm me objektin e prokurimit vlera e zërit pa tvsh 48.000 (dyzet e tetë mijë) lekë.

Faturë datë 11.04.2024 zërat e preventivit janë për pleh organik dhe kimik, vlera e faturës pa tvsh 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Faturë Nr.2, datë 04.05.2021 zërat e preventivit janë për pleh organik dhe kimik, vlera e faturës pa tvsh 100.000 (njëqind mijë) lekë.Fatura është jashtë afatit 3 vjeçar të parashikuar në dokumentat e tenderit dhe nuk mund të konsiderohet e vlefshme.

Faturë Nr.9, datë 19.02.2024 zërat e preventivit janë për pleh organik dhe kimik, vlera e faturës pa tvsh 54.545 (pesëdhjetë e katërmijë e pesëqind e dyzet e pesë) lekë.

Total ii faturave të paraqitura nga ky operator ekonomik është në vlerën 979.817 (nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë, duke mos plotësuar vlerën e kërkuar për furnizime të ngjashme në vlerën 1.387.583 (njëmilion e treqind e tetëdhjetë e shtatëmijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Operatori ekonomik sa më sipër nuk plotëson Kriteret e Vecanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.1.

**b) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, kapaciteti teknik pika 2.3.5 përcaktohet sa më poshtë:**

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient mbështetës të specializuar për maganizimin e plehrave dhe torfes me sipërfaqe mbi 5.000 (mijë) m<sup>2</sup> për të vërtetuar këtë operator ekonomik duhet paraqes dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë: *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen: *Kontratë huapërdorje.*

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira: *Kontratë qiraje.*

*Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik Besnik Çera ka paraqitur një certifikatë pronësie me totalin e sipërfaqes se pasurise 566m<sup>2</sup> duke mos plotësuar sipërfaqe 5000 m<sup>2</sup> të kërkuar. Gjithashtu është paraqitur një deklaratë legalizimi ku nuk përcaktohen m<sup>2</sup>. Pra sa më sipër referuar dokumentacionit të paraqitur operatori ekonomik nuk plotëson Kriteret e Vecanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.5.*

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve

ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “Besnik Çera” sh.p.k.nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**A l b G a r d e n**” **shpk** me Adresa: LEZHE Lagjja "Skenderbeg", godine private 1 kateshe ne superstraden Lezhe - Shkoder, km 1, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5 204 130 (pesëmilion e dyqind e katërmijë e njëqind e tridhjetë) leke pa tvsh është identifikuar si **ofertues i sukseshëm.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga“Xhezmi Delli”,Godina nr.20, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 5.734.500 (pesëmilion e shtatëqind e tridhjetë e katërmijë e pesëqind ) leke pa TVSH siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit,nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit,nga i cili nisin afatet e ankimit

PO  JO X

Nëse Po ( Nr.\_\_ Datë\_\_ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

